

Dalla sezione prescolare alla prima superiore

Nga parashkollori ne klasën e nëntë

# Benvenuti

2020-21 Iscrizioni aperte



## Cikli 9-vjeçar me parashkollor

### 2020-2021

Janë të hapura regjistrimet për vitin shkollor 2020-2021 në Shkollën Italiane në Tiranë, e vetmja shkollë italiane në Shqipëri, pjesë e rrjetit “Qendrat Dante në botë” të Shoqërisë Dante Alighieri.

Institucioni u prezantua si model **përsosmërie** i rrjetit Dante në Kongresin e 83-të Ndërkombëtar të Shoqërisë Dante Alighieri, që u mbajt në Buenos Aires nga 18 deri në 20 korrik 2019.

## Shkolla

Shkolla Italiane në Tiranë është e hapur për studentë të të gjitha kombësive dhe përfshin ciklin e studimeve **të shkollës fillore**, i cili fillon nga klasa I deri në klasën e V, dhe **grupin parashkollor**, një klasë lidhëse për fëmijët e moshës 5-6 vjeç, e krijuar për të shoqëruar dhe mbështetur nxënësit gjatë kalimit delikat nga kopshti në shkollën fillore. Nga shtatori i vitit 2020 do të jetë aktive edhe klasa e parë e **ciklit të mesëm të ulët**.

# Historiku

Institucioni lind në vitin 2017, mbështetur nga Ambasada Italiane në Tiranë, me vullnetin e tre mësueseve italiane, me qëllimin për të vepruar si urë kulturore dhe gjuhësore mes Italisë dhe Shqipërisë, vende të afërta si gjeografikisht ashtu edhe historikisht.

Që nga viti 2018 funksionon si shkollë ndërkombëtare me VKM Nr. 764/2017.

Në të njëjtin vit bëhet pjesë e Shoqërisë Dante Alighieri, një institucion kulturor i themeluar në vitin 1889 nga një grup intelektualësh të udhëhequr nga Giosuè Carducci, me qëllim "mbrojtjen dhe përhapjen e gjuhës dhe kulturës italiane në botë", e cila sot paraqet një rrjet të gjatë 480 komitete dhe 350 qendra çertifikimi në pesë kontinente.

# Didaktika

Shkolla garanton një didaktikë me cilësi të lartë bazuar në përfshirjen, bashkëpunimin dhe forcimin e potencialit individual.

Shkolla Italiane në Tiranë përdor **programe dhe tekste shkollore italiane**. Kurrikula është e njëjtë me atë të shkollës fillore italiane, ku studiohen lëndët Italisht, Matematikë, Shkenca, Histori, Muzikë, Art dhe Imazh, Gjeografi, Ed. Motor dhe Anglisht.

Mësimet zhvillohen në gjuhën italiane, me mësues të kualifikuar që kanë gjuhë amtare italishten. Gjuha shqipe mësohet në të gjitha klasat dhe është e detyrueshme për nxënësit me shtetësi shqiptare (me zgjedhje për nxënësit e huaj). Lënda e Muzikës dhe e Gjuhës Angleze përforcohet me një orë shtesë çdo javë, jashtë orëve kurrikulare të detyrueshme.

Stafi, i specializuar në mësimdhënie shumëgjuhëshe, kujdeset që të mundësojë një përfshirje të shpejtë të fëmijëve që nuk e kanë gjuhë amtare italishten, duke i udhëhequr me anë të një formimi paraprak për përforcimin e gjuhës italiane.

# Shërbimet

**Mensa.** Shërbimi i mensës ofrohet sipas standardeve të larta të cilësisë dhe higjienës. Kuzhinierja italiane përgatit receta si në mensat e shkollave italiane, me një menu të ekuilibruar dhe të shijshme, bazuar në përdorimin e produkteve cilësore me prejidhje të kontrolluar.

**Para dhe pas shkollës.** Mësimi fillon në 08:00 dhe mbaron në 13:15 (orar që mund të pësojë ndryshime). Pritja fillon në orën 07:30 dhe pas shkollës ka veprimtari deri në orën 16:00, për nxënësit që kanë nevojë për një orar më të zgjeruar.

**Aktivitetet jashtëshkollore.** Çdo pasdite nga ora 16:00 - 17:00 organizohen aktivitete jashtëshkollore opsionale me mësues të specializuar në: kërcim, basketboll, karate, capoeira, piano, saksofon dhe kurse kompjuteri me certifikim EiPass (European Computer Passport).

**Transporti.** Mundësohet shërbimi i transportit për nxënësit, me rezervim.

**Kurse dhe certifikime gjuhësore.** Shkolla Italiane në Tiranë është qendër certifikimi PLIDA (Projekti Gjuhës Italiane Dante Alighieri) dhe zhvillon kurse të gjuhës italiane.

**Tarifat.** Tarifa standarde vjetore është 3600€, përfshirë regjistrimin dhe mësimet kurrikulare, nga ora 8:00 e mëngjesit deri në 13:15 pasdite (orari i referohet vitit shkollor 19-20 dhe mund të pësojë ndryshime), të cilës i shtohen, sipas kërkesave dhe gjithnjë në bazë vjetore, mensa 500€, transporti 500€ dhe qëndrimi pas shkolle 500€.



**Shoqëria Dante Alighieri çdo vit jep një numër të kufizuar bursash me vlerë 1000€, në varësi të disponueshmërisë së vendeve dhe fondeve në dispozicion.**